



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2639/10 prot

Datë 25.10.2024

**V E N D I M**

**Nr. 1504/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.10.2024 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-11829-07-02-2024, me objekt: “Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”” me fond limit 316,793,525 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA, me adresë: Blv “Dëshmorët e Kombit” NR.3, 1001, Tiranë.

**Ankimues:**

BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK, përfaqësuar nga operatori ekonomik “Silver” shpk përkatësisht me NUIS K88010301S dhe NUIS J76705047U, me adresë: Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 Maji, Godina nr 7, Shkalla 4, Kati 1-re, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK, me NUIS K31510059D; me adresë: Rruga Faik Konica , Pallati Golden Park Residence , Hyrja Nr. 1, Kati Nr. 1, Zyra Nr.1, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.07.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-11829-07-02-

2024, me objekt: “Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”” me fond limit 316,793,525 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA.

II.2. Në datën 04.09.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

- |                                    |                                |
|------------------------------------|--------------------------------|
| 1. BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK | 292.000.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “Sori - AI” SHPK                | 302.149.920 lekë, kualifikuar  |

BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

1. BOE “S I L V E R” shpk me NUIS K88010301S & “NIKA” me NUIS J76705047U, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon: - Antari i BOE Operatori ekonomik “NIKA” shpk me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.1.1, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e Licencës të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila duhet të lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate. Licenca e paraqitur nga OE “NIKA” shpk LN-3194-04-2011, ka veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)” e cila nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në spitalin psikiatrik Ali Mihali, Vlorë”. Licenca e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të përfshijë si veprimtari specifike shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e tij, pra si veprimtari specifike e licencës II.1.A.1 duhet përveç gatimit edhe shpërndarja, pra shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim cateringu. Permbushja e këtij kriteri nga antari i BOE është detyrim sipas sipas pikës 3 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “per miratimin e rregullave te prokurimit publik” ku përcaktohet se “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. - Antari i BOE operatori ekonomik “NIKA” shpk me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.3.5, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1 (një) mjeteve transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Në kontratën e bashkëpunimit Nr. Repertori 5745, Nr. Koleksioni 1929 datë 30.07.2024 lidhur mes shoqërisë “S I L V E R” shpk me NUIS K88010301S & “NIKA” me NUIS J76705047U , në nenin 4 Pjesëmarrja, është përcaktuar se shoqëria “NIKA” shpk do të ketë një pjesëmarrje prej 45% të sasisë

*totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në spitalin psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe konkretisht furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit. Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga shoqëria “NIKA” shpk rezulton se kjo shoqëri nuk disponon një automjet frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore që ka marrë përsipër të realizojë..”*

II.3. Në datën (11)12.09.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

Perseri BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si me poshte vijon:

*BOE, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon:*

- *Anëtari i BOE Operatori ekonomik “NIKA” sh.p.k. me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.1.1, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e Licencës të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila duhet të lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate. Licenca e paraqitur nga OE “NIKA” sh.p.k. LN-3194-04-2011, ka veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (**Restorant**)” e cila nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në spitalin psikiatrik Ali Mihali, Vlorë”. Licenca e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të përfshijë si veprimtari specifike shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e tij, pra si veprimtari specifike e licencës II.1.A.1 duhet përveç gatimit edhe shpërndarja, pra shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim katering. Përbushja e këtij kriteri nga antari i BOE është detyrim sipas sipas pikës 3 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, **profesionale** dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

- *Anëtari i BOE operatori ekonomik “NIKA” sh.p.k. me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.3.5, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1 (një) mjeti transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore.*

*Në kontratën e bashkëpunimit Nr. Repertori 5745, Nr. Koleksioni 1929 datë 30.07.2024 lidhur mes shoqërisë “S I L V E R” sh.p.k. me NUIS K88010301S & “NIKA” me NUIS J76705047U , në nenin 4 Pjesëmarrja, është përcaktuar se shoqëria “NIKA” sh.p.k. do të ketë një pjesëmarrje prej 45% të sasisë totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në spitalin psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe konkretisht **furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit.***

*Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga shoqëria “NIKA” sh.p.k. rezulton se kjo shoqëri nuk disponon një automjet frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore që ka marrë përsipër të realizojë.*

*[...]*

*Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, .*

II.4. Në datën 17.09.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4568 dhe nr. 2639/2024 protokoli, datë 17.09.2024 e BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-11829-07-02-2024, me objekt: “Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”” me fond limit 316,793,525 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

*“ [...]*

*Pretendimi i AK se licenca nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi dhe shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim katering u nuk qëndron.*

*Ne nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndet e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”. Pra, licenca e paraqitur përfshin deri në procesin e furnizimit të konsumatorit përfundimtar qoftë ky në ambient apo jashtë ambienteve. Emertimi përkrahës i veprimtarisë “Restorante” nuk e pengon në asnjë moment realizimin e qëllimit të kontratës që është: Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë”.*

*Ju bëjmë me dije se çdo subjekt i licencuar për prodhim ushqimi mund të sigurojë shërbime katering u pa patur nevojën e një licence të vecantë vetëm për katering. Sqarojmë se shërbim katering u nenkupton disponimin e një ambienti i cili shërben vetëm si kuzhinë për prodhimin e ushqimit dhe me tej shpërndarjen e tij.*

*Ndërsa restoranti nenkupton disponimin e një ambienti për prodhim ushqimi, gjithashtu edhe ambient për konsumimin e ushqimit, por kjo nuk e kufizon në asnjë moment shpërndarjen e ushqimit jashtë ambienteve. Fjala katering për të cilin AK ka bërë refuzimin e ofertës nuk është përmendur në asnjë pikë të DST dhe rrjedhimisht nuk duhet të jetë kriter skualifikues.*

*- Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Per licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”.*

Gjithashtu, ne Aneksin 3 “Permbajtja orientuese e titullit te licences dhe kerkeses” ne piken 8 Emertimi i veprimtarise(ve) specifike te licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarise specike kur kjo eshte e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kerkuar te ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendosen emeritimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kerkuar te licencohen. c) Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere ateherë vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkelidhur Nr??”

- Ne nenin 3, pika 16, te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Faza te prodhimit, perpunimit dhe shperndarjes” eshte cdo faze, perfshire importet dhe lendet e para per prodhimin e ushqimeve, perfshire ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit perfundimtar dhe, ne menyre te ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shperndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve per kafshe”.

- Ne nenin 19, pika 1, te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Veprimtarite e prodhimit primar, te perpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumice apo pakice, perfshire edhe ne hapesira te levizshme dhe/ose te perkohshme, te percaktuara ne kete ligj, perfshihen ne kategorine II.1 te shtojces se ligjit per licencat. Licencimi i ketyre veprimtarive, per cdo operator e per cdo stabiliment, behet sipas ligjit per licencat.

- Ne shtojcen e ligjit Nr. 10 081, date 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”, Fusha II “Ushqimi dhe shendeti”, parashikohet shprehimisht: Fusha II. Ushqimi dhe Shendeti

41. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

52.Licence Sherbime te Riprodhimit, Krijimit te Racave ose Veterinare

63.Licence Rritja ose Tregtimi i Kafsheve

74. Licence Prodhimi dhe/ose Tregtimi i Farerave dhe/ose Fidaneve

85. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve te Mbrojtjes se bimeve, plehrave kimike dhe/oseprodukteveprejduhaneve.

96.Licence sherbime mjekesore paresore, spitalore ose te stomatologjise.

107.Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave per njerez ose kafshe.

118.Licence sherbime te tjera shendetesore dhe/ose higjiene-sanitare.

- Ne aneksin 1 te VKM Nr.538, date 26.5.2009 “Per Licencat dhe Lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketae, Fusha II “Ushqimi dhe Shendeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “Prodhimit dhe/ose tregtimit te ushqimeve” eshte kategoria II.1 e shtojces se Ligjit nr. 10 081, date 23.2.2009 “Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”.

2.Kjo licence ndahet ne keto nenkategorji:

a) “Prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumice”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtarite e nenkategorise me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk perfshijne veprimtarite per te cilat parashikohet licencimi i posacem sipas kategorise II.3 te shtojces se ligjit nr.10 081, date 23.2.2009 “Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”.

4. Licencat per nenkategorite II.1.A, II.1.B dhe II.1.C jane pa afat.

- Ne nenin 17, “Rregulla te perbashketa per kerkesen per licence/autorizim/leje per te gjitha grupet” te ligjit nr. 10081, date 23.02.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”, parashikohet shprehimisht se:

1. Kerkesa per licence/autorizim/leje apo nenkategorit te tyre paraqitet ne QKL, sipas procedurave te nenit 34 te ketij ligji.

2. Kerkesa perbehet nga formulari tip i plotesuar dhe dokumentet shoqeruese perkatese.

3. Formulari tip permban, te pakten, keto te dhena:

a)emertimin e kategorise/nenkategorise;

b) llojin e veprimtarise, veprimt apo te se mires publike e te perdorimit te saj;

c) te dhenat per identifikimin e kerkuesit dhe te personit qe paraqet kerkesen;

ç) vendin apo vendet e ushtrimit te veprimtarise, te kryerjes se veprimt apo perdorimit te se mires;

d) te dhenat e tjera specifike, sipas kategorise/nenkategorise;

dh) deklaraten e kerkuesit, qe verteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i permbush ato (pe rkreret, permbushja e te cilave vetedeklarohet);

e) deklaraten per vertetesine e dokumenteve shoqeruese dhe/ose qe i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i permbushe ato;

ë) adresen per komunikim;

f) listen e dokumenteve shoqeruese qe duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund te kerkoje paraqitjen e dokumenteve apo dhenien e informacioneve te tjera, te paparashikuara ne formular.

5. Formulari i plotesuar dhe dokumentet shoqeruese, per cdo kerkese te paraqitur, publikohen nga QKL-ja ne regjister, brenda dites se neserme te punes nga data e paraqitjes se kerkeses.

- Ne nenin 23, “Permbajtja e titullit te licences/autorizimit/lejes” te ligjit nr. 10081, date 23.02.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”, parashikohet shprehimisht se:

1. Licenca/autorizimit/leja leshohet ne baze te formulareve te miratuar, qe perbejne titullin e saj.

2.Titulli permban, te pakten, keto te dhena:

a)emrin dhe stemen e QKL-se;

b)serine, numrin dhe daten e miratimit dhe te hyrjes ne fuqi;

c)te dhenat per identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarise, veprimt apo te se mires publike dhe te perdorimit te saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo perdoret e mira (nese eshte percaktuar si e dhene e nevojshme per kategorine/nenkategorine);

dh) kufizimet ne ushtrimin e veprimtarise, ne kryerjen e veprimt apo ne perdorimin e se mires publike (nese ka);

e)afatin e vlefshmerise;

ë) nenshkrimin e perfaqesuesit te autorizuar te QKL-se dhe vulen perkatese te institucionit;  
f) te dhenat e tjera specifike, sipas kategorise/nenkategorise;  
g) aneksin.

3. Aneksi permban te gjitha detyrimet specifike apo te pergjithshme, sipas legjislacionit ne fuqi, qe duhet te respektoje titullari gjate te gjithë periudhes se vlefshmerise se sa.j  
Referuar me siper, BOE e permbush kerkesen e AK si per prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez. Duke ju referuar, procedures se zhvilluar nga i njejti AK me Nr.REF-07629-05-31-2024 me objekt: “Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik Koco Gliozheni”, Vendimit te KVO nga ky AK, per kualifikimin si oferte e sukseshme te ofertes te OE “Drive Expert Albania” sh.p.k, vendimit te KSHA nga ky AK, per te mos pranuar ankesen e bere nga OE “Dajti Park 2007” sh.p.k me pretendim te njejte kundrejt OE fitues ashtu sic AK pretendon per anetarin e BOE operatorin ekonomik “Nika” shpk dhe Vendimit te KPP nr. 1226/2024 me nr. 2288/8 prot., date 10.09.2024, na lind e drejta te mendojme qe AK PER KRITERE DHE DOKUMENTACION TE NJEJTE, GJYKON ME DY STANDARTE.

#### Se dyti

[...] Ne DST nga AK eshte kerkuar:

Shtojca 8

LOTI 2: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPERNDARJA E USHQIMIT NE SPITALIN PSIKIATRIK “ALI MIHALI” VLORË”

[shtojce per tûu plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT

2. Ofertuesi duhet te paraqese:

2.3. Aftesite teknike dhe profesionale:

2.3.3 2.3.5. Operatoret ekonomike duhet te disponojne minimumi 1 (nje) mjet transporti frigoriferik, per transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund te jene ne pronesi, qira apo perdorim sipas rregullimeve ligjore.

Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret ekonomike duhet te paraqesin: dokumentacion te plote si akti qe verteton pronesine, kontrate qiraje apo perdorimi dhe leje qarkullimi.

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 9 te DT.

Dokumentet provuese te kerkuara me siper, do te paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit,ose nese kerkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Per te permbushur kete kriter BOE SILVER & NIKA shpk perfaqesuar nga Silver shpk, me prokure te posacme me NR.Rep. 5744, Nr.Kol.1928 date 30/07/2024 ka paraqitur ne SPE dokumentacionin si me poshte:

- 2.Formulari\_permbledhes\_vetedeklarimit\_NIKA

-2.1Formulari\_permbledhes\_vetedeklarimit\_SILVER

- 12.Tabela\_e\_Stafit-BOE

-15.AB372AG Mjeti\_Frigoriferik\_ATV



*-21.Kontrate bashkepunimi Silver\_Nika*

*-Formulari\_permbledhes\_vetedeklarimit\_NIKA*

*Ku duket qarte qe anetari i BOE operatori ekonomik “Nika” SHPK ka shoferin e mjetit frigoriferik si pjese e stafit te BOE.*

*-Formulari\_permbledhes\_vetedeklarimit\_SILVER*

*Ku duket qarte qe anetari i BOE operatori ekonomik “Silver” SHPK ka mjet frogoriferik ne pronesi, mjet qe do te perdoret nga BOE.*

*- Tabela\_e\_Stafit-BOE*

*Ku duket qarte stafi qe ka ofruar cdo anetar i BOE per realizimin e sherbimit.*

*Konkretisht anetari i BOE operatori ekonomik “Nika” SHPK ka ofruar te gjithë punonjesit e shperndarjes qe nevojiten pra 4 vete dhe nje shofer.*

*- 15.AB372AG Mjeti\_Frigoriferik\_ATV*

*Dokumentacioni ligjor per Mjet frigoriferik ne pronesi te Silver shpk*

*21.Kontrate bashkepunimi Silver\_Nika*

*Ne kete kontrate eshte shprehur ndarja e puneve por jo e mjeteve dhe pajisjeve. Nga momenti qe nje nga anetaret e BOE e posedon ne pronesi mjetin frigoriferik, anetari tjetër ofron drejtuesin e mjetit. Qellimi i nje BOE eshte bashkimi i kapaciteteve per realizimin e sherbimit.*

*Pra pretendimi i AK, se anetari i BOE operatori ekonomik “Nika” SHPK, me NUIS J76705047U nuk ploteson piken 2.3.5, te seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike, te Kriteve te vecanta te Kualifikimit te percaktuara ne DT, lidhur me disponimin e 1 (nje) mjeti transporti frigoriferik, per transportin e produkteve ushqimore, me rezultat skualifikimin e ofertes tone, nuk qendron.*

*Rjedhimisht mendojme se vendimi i AK per skualifikimin e ofertes tone eshte i padrejte dhe do te sjelle nje dem ekonomik serioz te buxhetit te shtetit, ne nje vlere prej 10,149,920 (dhjete milion e njeqind e dyzet e nente mije e nenteqind e njezet) Lekë.”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.2639/5, datë 26.09.2024, me arsyet e skualifikimit që BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 2639 prot.

II.6. Në datën 30.09.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 2639/6, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 714/11 prot., datë 27.09.2024 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankeses se paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike “Silver” SHPK dhe “Nika” SHPK, lidhur me vleresimin e ofertave ne proceduren e prokurimit me nr.REF-11829-07-02-2024, me objekt: Loti II, “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së me nr. 714/10 prot., date 26.09.2024 “Mbi ankesën e paraqitur nga BOE “Silver” SHPK dhe “Nika” SHPK”. Sipas këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e BOE “Silver” SHPK dhe “Nika” SHPK”.

II.7. Në datën 02.10.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik, me nr. 2639/7 prot., “Formulari i paraqitjes së argumenteve”, nga operatori ekonomik i interesuar “Sori-AI” SHPK, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, .

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, pika 1.1.1, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*1.1.1. Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)*

Ndërsa në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5. “Kapaciteti teknik e profesional”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është parashikuar nga autoriteti kontraktor kriteri si më poshtë:

*2.3.5. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.*

*Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.*

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, pjesë e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, është përcaktuar si vijon:

#### **Shtojca 5.**

**LOTI 2: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJA E USHQIMIT NË SPITALIN PSIKIATRIK “ALI MIHALI”, VLORË”**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR DIETAT**

Nr	Pershkrimi i dietave
1	DIETA USHQIMORE Nr.14 PER PACIENT
	≈ 3000 k. kal. (Proteina-122 gr, lip.108 gr,gluc.385gr)
2	DIETA USHQIMORE Nr.14 PER MJEKUN E ROJES
	≈ 3000 k. kal. (Proteina-122 gr, lip.108 gr,gluc.385gr)

**DIETA USHQIMORE PER PACIENT/MJEKUN E ROJES**

Nr.	ASORTIMENTI	Nj.Matjes	Sasia
1	Qumesht/Kos	ml	600
2	Buke	gr	300
3	Zarzavate	gr	500
4	Vaj	ml	30
5	Mish	gr	200
6	Fruta	gr	400
7	Veze	kokerr	1
8	Djathe/Gjize.	gr	100
9	Oriz	gr	110
10	Gjalp	gr	15
11	Sheqer	gr	30

**Specifikimet e artikujve ushqimorë që do të përdoren për zbatimin e dietave në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë:**

**Buke gruri :**

- Te jete e pjekur mire ne masen 1 kg pa ere myku ,thartire dhe hidherimi dhe ere e shije tjeter te huaj.
- Duhet të jetë me rreze 75% e gatuar brenda ditës dhe me miell të papërzier Cilesia te jete sipas standartit shteteror Shqiptar.
- Buka duhet të jetë e prerë në feta dhe e ambalazhuar në qese prej letre dhe te dergohet per konsum jo me pare se 3 ore nga koha e pjekjes dhe te jete e shoqeruar me raport analize nga A.K.U
- Transporti I bukes te behet me mjete te pastra te mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportimin e produkteve ushqimore .

**Orizi :**

- Te jete me kokrra te pasterta ,te zhveshura teresisht nga levozhga e orizit ,pa shije ,pa shenja myku ose prishje .
- Treguesit teknik te jene sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Te jete I amballazhuar ne pako 1 kg ku te jete shenuar afati I skadences mbi nje vit nga data e furnizimit.

#### **Sheqer :**

- Pluhuri te jete I perbere nga kristale te imet dhe te njellojte pa lende te huaja.
- Treguesit teknik sipas Standarteve Shteteror Shqiptar
- Amballazhimi : te jete me pako prej letre 1 kg neto ku te jete shenuar edhe afati I skadences mbi 1 vit nga data e furnizimit.

#### **Vaj gjelle :**

- Te jete leng vajor , me ngjyre te verdhe me shije te mire karakteristike e vajit te lulediellit te rafinuar,pa shije dhe ere te huaj
- Treguesit kimik sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Amballazhimi do te jete ne shishe plastike me vellim 1 litershe.te mbyllur me tape plastike me vidhezim hermetike te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese
- Mbi cdo shishe do te vendoset etiketa ne te cilen do te shenohet :
  - Emertimi I plote I mallit
  - Data e skadimit ose afati I perdorimit qe do te jete mbi nje vit nga data e furnizimit

#### **Vaj ulliri :**

- Te jete leng vajor me ngjyre ulliri ,pa shije dhe ere te huaj
- Treguesit kimik sipas standartit shteteror shqiptar
- Amballazhimi do te behet ne shishe plastike ose qelqi me vellim 0.5 ose 1 lit ,te mbyllur me tape plastike me vidhezim hermetike te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese.
- Mbi cdo shishe do te vendoset etiketa nete cilen te shenohet
- Emertimi I plote I mallit
- Data e skadimit ose afati I perdorimit qe do te jete mbi nje vit nga data e furnizimit

#### **Mishi vici :**

- Te jete cilesi e pare ,me muskulature te zhvilluar mire dhe jo ne gjendje te ngrire ,te mos kete shume dhjame dhe ne qofte se ketë të jetë ngjyrë i bardhë,veshka të mos jetë e mbuluar me dhjame më tepër se 50%,dhe kocka te mos duket pasi te jete mbuluar nga mishi.
- Mishi do te perbehet nga pjese e perparme dhe e pasme propocionalisht,koka ,melcia e zeze,e bardhe ,kembet si dhe te perbrendshmet nuk futen ne perberjen e mishit .
- Pjesa e shpatulles kofshe dhe gjoks duhet te jete e vulosur me vulen e kontrollit veterinar.
- Cdo parti mishi duhet te shoqerohet me certificate veterinare
- Vula e raportit veterinari te jene te lexueshme mire .
- Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga Inspektoriati Veterinar.

- *Treguesit kimik ne perputhje me Standartin Shteteror Shqiptar.*

#### **Mish i pulës:**

- *Te jete I fresket ,prodhim vendi dhe ne etikete te jete shenuar edhe origjina e prodhuesit.*
- *Pamja e jashtme e pulës te jete ngjyre roze e celur qe anon ne te bardhe karakteristike te mishit te pulës se fresket pa shtresa te teperta dhjami cilesi e pare .*
- *I shoqeruar me raport analize nga Inspektoriati Veterinar.*
- *Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga Inspektoriati Veterinar.*
- *Treguesit kimik ne perputhje me Standartin Shteteror Shqiptar*

#### **DJATHI :**

- *Të jetë i cilësisë I me këto karakteristika :*
- *Të ketë pamje homogjene ,formë të mirë dhe pa deformime , i fortë ,me erë dhe shije të kendshme*
- *Lënda e thatë të jetë jo më pak se 48 % , yndyra në lëndën e thatë të jetë 50% yndyra e përgjithshme të jetë 26 % ,kripa 5%.*
- *Të mos ketë mikroorganizma dhe djathi të jetë i konsumueshëm pas 60 ditësh nga dita e prodhimit .Lagështia të jete 15 %.*
- *Te jete i shoqeruar me flete analize nga AKU*
- *Amballazhimi te behet ne voza plastike me vellim 5-30lit .Djathi ne voze qendron i mbuluar me shelliren fillestare.*
- *Mbi cdo ambalazh ne djath vendoset etiketa ne te cilen shenohen emri i prodhuesit ,emri i produktit ,pesha neto ose vellimi i produktit si dhe data e prodhimit .*
- *Transporti te behet me mjete te mbuluara dhe te destinuara per transport bulmeti.*

#### **GJALPI :**

- *Te jete gjalp prodhim vendi,me shije te mire,pa lende te huaja ne perberje ,i fresket cilesor sipas standarteve shteterore*
- *Te jete i shoqeruar me flete analizen nga AKU dhe te jete i shoqeruar me etiketen e firmes prodhuese ne ambalazh dhe afatet kohore te perdorimit si dhe data e skadences te perkoje me skadencen ne fleten e analizes se AKU*
- *Gjalpi të ketë ngjyrë kremi në të verdhë me 81 %*
- *yndyrë ,17 % lagështi dhe 2 % lëndë e thatë .*
- *Transporti te behet me mjete te mbuluara dhe te destinuara per transport bulmeti.*

#### **QUMËSHTI :**

- *Të jetë qumësht lope e cilësisë së parë me 1.5% -2 % yndyre*
- *Qumështi që do të vijë në Spital të jetë prodhim i asaj dite dhe të ketë ngjyrë të bardhë ,erë të këndëshme ,pak i ëmbël pa shije te hidhur dhe djegese te percaktuar ne standartet shteterore .*
- *Amballazhimi te jete ne shishe plastike me vellim 1 lit-1.5 lit I mbyllur me kapak hermetik shoqeruar me flete analizen leshuar nga AKU dhe afatin e perdorimit*
- *Transporti te behet me mjete te specializuara te shitesit ne oret e para te mengjesit.*

**KOS:**

- *Te jete i zene me qumesht qe permbush karakteristikat e mesiperme.*
- *Te jete i ambalazhuar ne gota plastike 200gr.ne te cilet te tregohet firma prodhuese dhe afati i skadences*

**GJIZE :**

- *Te jete cilesor ,pa kripe ,pa njolla lende te huaj,te mos jete e hidhur dhe me shije te kendshme Brenda kushteve teknike.*
- *Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU dhe te kete etiketen e firmes prodhuese ne amballazh.*
- *Afati I skadences ne etikete te perkoje me daten e skadences ne fleten e analizes nga AKU*
- *Transporti te behet me mjete te mbuluara te destinuara per transport bulmeti.*

**PERIMET DHE ZARZAVATET E TJERA**

*Te jene te cilesise se pare, te fresketa, sipas stines te ambalazhuar ne menyre qe te mos demtohen gjate transportit*

**VEZET :**

- *Te jene pule ,prodhim vendi*
- *Kokrra e vezes te jete e fresket ,te kete emrin e prodhuesit dhe te jete shoqeruar me analizen e proves nga AKU .*
- *Te kete shenuar mbi levozhge kodin qe duhet te perkoje me kodin e vendosur ne fleten e analizes se AKU.*

**FRUTAT**

- *Te jene te fresketa cilesia e pare ,sipas stines.*

III.1.3. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 9**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT****Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit****B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj</i>	<i><u>Punonjës</u></i>

<p>nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/></p>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____ <b>Firma</b> _____ <b>Vula</b> _____ <b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>	

**Ju lutemi sigurohuni që:**

Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit. [...]

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. [...]

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK, në përmbushje të kriterëve sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:

- a. Kontratë bashkëpunimi Nr.Repertori 5745; Nr.Koleksioni 1929, me datë 30.07.2024, me palë shoqërinë “Silver” SHPK dhe shoqërinë “Nika” SHPK. Sipas Nenit nr.2 objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohshëm i shoqërive për të marrë pjesë konform procedurave përkatëse për konkurimin që do të zhvillohet pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA me objekt: “Loti 2 “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”. Në nenin 4 “Pjesëmarrja” të kësaj kontrate thuhet shprehimisht:

1. Pjesëmarrja e shoqërive e shprehur ne përqindje ne arritjen e objektit te kësaj kontrate do te jene si me poshtë vijon:

Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”

-Shoqëria “SILVER” Shpk do te këtë një pjesëmarrje prej 55% (pesedhete e pese perqind) te sasise totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë” dhe konkretisht venien ne dispozicion te ambjentit, drejtimin e sherbimit me ane te drejtuesit teknik, pergatitjen dhe gatimin e ushqimit.).

-Shoqëria “NIKA” Shpk do te këtë një pjesëmarrje prej 45% (dyzet e pese perqind) te sasise totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali

*Mihali”, Vlorë” dhe konkretisht me furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit te gatuar dhe shperndarjen e ushqimit).*

*2. Te gjithë aktivitetin për te përmbushur detyrimet sipas kësaj marrëveshje, palët ne këtë kontrate Partneriteti do ti kryejnë se bashku, duke bere bashkimin e mjeteve financiare, mjetet e punës, dhe personelin. Palët kane rene dakort qe detyrat do t'i ndajnë sipas marrëveshjes se miratuar me pare nga te dyja palët.*

*3. Sipas nenit 423 te Kodit Civil, shoqëritë (Bashkimi i shoqërive) mbajnë përgjegjësi solidare ose veç e veç, ndaj Operatorit te Blerjeve te Perqendiuara sha ne cilësinë e autoritetit kontraktues, ne lidhje me kushtet e përcaktuara ne raste shpallje fitues ne procedurën perzgjedhese konkurruese për objektin e këtij bashkëpunimi, te sipërcituar.*

*4. Shoqëria “SILVER” shpk merr përsipër menaxhimin dhe administrimin e punes duke vene ne dispozicion tërësisht fuqinë punëtore, te transportit, personelin dhe duke u përfshirë, por pa u kufizuar ne çdo lloj veprimi, kontakt negociate, apo përfaqësimi te këtij grupimi para dhe pas nënshkrimit te kësaj kontrate.”*

- b. Licencë LN-1454-11-2020, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Silver” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Bar-Restorant-Katering; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Vlorë, Rrethi Vlorë B/K: Q/F: Adresa: ...”
- Miratim Kërkese nr. 4453/2 prot., datë 17.11.2020, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit.
- Licencë LN-5437-03-2023, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Silver” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specilaiteti- Shërbim gatimi, katering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Vlorë, Rrethi Vlorë Orikum B/K: Q/F: Adresa: ...”
- Akt miratimi nr. 1041/3 prot., datë 15.03.2023, lëshuar nga Autoriteti Kombtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit.
- Licencë LN-4682-09-2022, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Silver” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specilaiteti- Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, katering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: ...”
- Miratim Kërkese nr. 52/3 prot., datë 19.09.2022, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit.



- Licencë LN-5304-02-2023, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Silver” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specialiteti- Shërbim gatimi, catering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: ...”
- Akt miratimi nr. 474/4 prot., datë 16.02.2023, lëshuar nga Autoriteti Kombtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Licencë LN-6349-09-2023, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Silver” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specialiteti- Shërbim gatimi, catering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: : Qarku: Vlorë, Rrethi Vlorë Orikum B/K: Q/F: Adresa: Adresa: ...”
- Akt miratimi nr. 4397/4 prot., datë 19.09.2023, lëshuar nga Autoriteti Kombtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- c. Licencë LN-3194-04-2011, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Nika” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: Adresa: ...”
- Miratim Kërkese nr. 595/2 prot., datë 08.03.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit ku thuhet shprehimisht: “Mbështetur në ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, VKM-në nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së); Fusha II, Ushqimi dhe Shëndeti, si dhe në kërkesën me numer LC-4294-02-202, subjekti “Nika” SHPK, Qarku Shkodër, me NUIS/NIPT J76705047U, me numër titulli të licencës në zotërim LN-3194-04-2011 dhe aktivitetet: “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike: “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)”, ka aplikuar për ndryshim adrese pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB-së). Në bazë të shkresës nr.prot. 270/2, datë 25.02.2021 të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Shkodër, paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, subjektit i është kryer inspektimi në vend nga inspektorët e

kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti “Nika” plotëson kushtet dhe kriteret kërkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licencim.

- Licencë LN-1085-03-2010, Kodi II.1.B., në emër të subjektit “Nika” SHPK; [...]
- Miratim kërkesë nr. 567/2 prot., datë 26.02.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit për licencën II.1.B.

d. Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Silver” SHPK;

e. Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Nika” SHPK.

III.1.5. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor, të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.6. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

*duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se:

*“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa neni 92/3 i LPP-së përcakton se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.8. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*

*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.1.9. Në nenin 40, pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.1.11. Në nenin 88 pika 1, 2 dhe 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

*2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

III.1.12. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i veprimtarise(ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarise specifike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar të ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendoset emeritimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kërkuar te licencohen. c) Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....”

III.1.13. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se:

*“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.1.14. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

*Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti*

*4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*

*5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare*

*6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve*

*7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve*

*8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.*

*9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.*

*10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.*

*11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.*

III.1.15. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

*1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

*2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:*

*a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*

*b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*

*c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

*3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

*4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.*

III.1.16. Në nenin 17, “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

*1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.*

*2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.*

*3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:*

*a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;*

*b) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;*

*c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;*

*ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimin apo përdorimit të së mirës;*

*d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;*

*dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);*



e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njih dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.1.17. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe stemën e QKL-së;

b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

c) të dhënat për identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarisë, veprimit apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);

dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e së mirës

publike (nëse ka);

e) afatin e vlefshmërisë;

ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;

f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;

g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi,

që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

III.1.18. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, të ndryshuar. Zbatimi i parimit

të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

III.1.19. Referuar sa më lart, vërehet, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të disponojnë Licencë të kategorisë *“II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* si dhe të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, i cili mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK rezulton se në SPE është dorëzuar Kontrata e bashkëpunimit me datë 30.07.2024, e lidhur midis shoqërisë “Silver” SHPK dhe shoqërisë “Nika” SHPK dhe sipas nenin 4 “Pjesëmarrja” të kësaj kontrate [...] *shoqëria “SILVER” Shpk do të ketë një pjesëmarrje prej 55% të sasise totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë” dhe konkretisht venien në dispozicion të ambjentit, drejtimin e shërbimit me ane të drejtuesit teknik, përgatitjen dhe gatimin e ushqimit dhe shoqëria “NIKA” Shpk do të ketë një pjesëmarrje prej 45% të sasise totale të procedurës dhe konkretisht me furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit. Gjithashtu në pikën 4 të këtij neni është përcaktuar se shoqëria “SILVER” shpk merr përsipër menaxhimin dhe administrimin e punës duke vene në dispozicion tërësisht fuqinë punëtore, të transportit, personelin dhe duke u përfshirë, por pa u kufizuar në çdo lloj veprimi, kontakt negociate, apo përfaqësimi të këtij grupimi para dhe pas nënshkrimit të kësaj kontrate.*

Për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor: *“Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* rezulton se shoqëria “Silver” SHPK ka paraqitur në SPE Licencë LN-1454-11-2020, Kodi II.1.A., Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Bar-Restaurant-Katering; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Vlorë, Rrethi Vlorë B/K: Q/F: Adresa: ...”; Miratim Kërkese nr. 4453/2 prot., datë 17.11.2020, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit; Licencë LN-5437-03-2023, Kodi II.1.A., Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specilaiteti- Shërbim gatimi, catering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Vlorë, Rrethi Vlorë Oriku B/K:

Q/F: Adresa: ...”; Akt miratimi nr. 1041/3 prot., datë 15.03.2023, lëshuar nga Autoriteti Kombtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit; Licencë LN-4682-09-2022, Kodi II.1.A., Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specialiteti- Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, catering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: ...”; Miratim Kërkese nr. 52/3 prot., datë 19.09.2022, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit; Licencë LN-5304-02-2023, Kodi II.1.A., Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specialiteti- Shërbim gatimi, catering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: ...”; Akt miratimi nr. 474/4 prot., datë 16.02.2023, lëshuar nga Autoriteti Kombtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit; Licencë LN-6349-09-2023, Kodi II.1.A., Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Specialiteti- Shërbim gatimi, catering; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: : Qarku: Vlorë, Rrethi Vlorë Oriku B/K: Q/F: Adresa: Adresa: ...”; Akt miratimi nr. 4397/4 prot., datë 19.09.2023, lëshuar nga Autoriteti Kombtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit.

Ndrësa shoqëria “Nika” SHPK ka paraqitur në SPE dokumentin Licencë LN-3194-04-2011, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Nika” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: Adresa: ...”, shoqëruar me Miratim Kërkese nr. 595/2 prot., datë 08.03.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombetare të Biznesit ku thuhet shprehimisht: “Mbështetur në ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, VKM-në nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së); Fusha II, Ushqimi dhe Shëndeti, si dhe në kërkesën me numer LC-4294-02-202, subjekti “Nika” SHPK, Qarku Shkodër, me NUIS/NIPT J76705047U, me numër titulli të licencës në zotërim LN-3194-04-2011 dhe aktivitet: “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike: “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)”, ka aplikuar për ndryshim adrese pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB-së). Në bazë të shkresës

nr.prot. 270/2, datë 25.02.2021 të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Shkodër, paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, subjektit i është kryer inspektimi në vend nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezultojnë: Subjekti “Nika” plotëson kushtet dhe kriteret kërkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licencim.

Gjithashtu është paraqitur Licenca LN-1085-03-2010, Kodi II.1.B., në emër të subjektit “Nika” SHPK; [...] dhe Miratimi i kërkesës nr. 567/2 prot., datë 26.02.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit për licencën II.1.B, që nuk përputhet me kërkesën e AK për kategorinë II.1.A.

Për sa i përket mjetit të transportit frigoriferik, shoqëria “Silver” SHPK ka paraqitur Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku në Pjesën e III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” për realizimin e objektit të prokurimit ka deklaruar mjet frigoriferik me leje higjienosantare; ndërsa shoqëria “Nika” SHPK ka paraqitur Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit por në Pjesën e III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” për realizimin e objektit të prokurimit nuk ka deklaruar se disponon mjet frigoriferik.

III.1.20. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht nëneni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret referuar nenit 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, referuar objektit të prokurimit si dhe kontratës së bashkëpunimit lidhur me ndarjen e shërbimeve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Nika” SHPK, ka marrë përsipër 45% të kontratës dhe konkretisht do të kryejë furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit, për të cilat është i nevojshëm mjeti frigoriferik.

III.1.21. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.22. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht nëneni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “Silver” SHPK & “Nika” SHPK”, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: Kontratë bashkëpunimi sipas të cilës Shoqëria “SILVER” Shpk do të ketë një pjesëmarrje në bashkëpunim prej 55% ndërsa shoqëria “NIKA” Shpk 45%. Shoqëria “SILVER” Shpk do të verë në dispozicion ambjentin, drejtimin e shërbimit me ane të drejtuesit teknik, përgatitjen dhe gatimin e ushqimit, ndërsa Shoqëria “NIKA” Shpk do të kryejë furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit. Te gjithë aktivitetin

për te përmbushur detyrimet sipas kësaj marrëveshje, palët do ti kryejnë se bashku, duke bere bashkimin e mjeteve financiare, mjetet e punës, dhe personelin. Përveç sa me sipër, shoqëria “SILVER” shpk ka marrë përsipër menaxhimin dhe administrimin e punes duke vene ne dispozicion tërësisht fuqinë punëtore, te transportit, personelin dhe duke u përfshirë, por pa u kufizuar ne çdo lloj veprimi, kontakt negociate, apo përfaqësimi te këtij grupimi para dhe pas nënshkrimit te kësaj kontrate.

Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punëve dhe shërbimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar shërbimet, që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” SHPK, ka marrë përsipër të kryejë furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit te gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit, për të cilat është i nevojshëm mjeti frigoriferik, kërkesë e cila nuk është plotësuar nga ky i fundit, pasi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga ana e tij nuk është deklaruar disponimi i mjetit të transportit frigoriferik.

Përveç kësaj, edhe licensa e paraqitur nga kjo shoqëri dhe konkretisht: Licencë LN-3194-04-2011, Kodi II.1.A., në emër të subjektit “Nika” SHPK; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtimi përshkrues i veprimtarisë – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku: Shkodër, Rrethi Shkodër B/K: Q/F: Adresa: Adresa: ...” shoqëruar me Miratim Kërkese nr. 595/2 prot., datë 08.03.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit ku thuhet shprehimisht: “Mbështetur në ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, VKM-në nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së); Fusha II, Ushqimi dhe Shëndeti, si dhe në kërkesën me numer LC-4294-02-202, subjekti “Nika” SHPK, Qarku Shkodër, me NUIS/NIPT J76705047U, me numër titulli të licencës në zotërim LN-3194-04-2011 dhe aktivitet: “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, veprimtari specifike: “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)”, ka aplikuar për ndryshim adrese pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB-së). Në bazë të shkresës nr.prot. 270/2, datë 25.02.2021 të Drejtorisë Rajonale të Qarkut Shkodër, paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, subjektit i është kryer inspektimi në vend nga inspektorët e kësaj Drejtorie dhe rezulton: Subjekti “Nika” plotëson kushtet dhe kriteret kërkatëse ligjore për zhvillimin e aktivitetit të kërkuar për licencim”, për mungesë të

mjetit frigoriferik, aktualisht nuk është në kushtet e plotësimit të kërkesës së autoritetit kontraktor se: *“Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, për shpërndarjen e ushqimit të gatshëm.*

Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110, pika 1 e LPP. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se ankimuesi do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, të ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, parashikohet se: “[...]1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.. [...]”*

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-11829-07-02-2024, me objekt: “Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”” me fond limit 316,793,525 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara SHA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE “Silver” SHPK & “Nika” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

